

GREEN COAST SHPK

**Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2017
(se bashku me Raportin i Audituesit te Pavarur)**

Permbajtja	Faqja
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i,ii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE E TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	3
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	4
SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE	5-13



BAKER TILLY ALBANIA

Rr.Themistokli Gërmenji, Nr.2
Pall.Ambasador 1, 3-rd floor
Tirana, Albania

T: +355(0)42232726

office@bakertillyalbania.com
www.bakertillyalbania.com

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Green Coast Shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2017, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK") miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

Baza për Opinion

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAs). Përgjegjësia jone sipas këtyre standardeve përshkruhet në vijim në seksionin e raportit tonë Përgjegjësia e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim i cështjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2016 nuk janë audituar. Për pasojë ne nuk shprehim një opinion mbi to.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimesisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur drejtimi synon të likuidojë Shoqërinë ose të pushojë veprimtarinë, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër realiste përveç kesaj.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë dhenia e sigurise së arsyeshme nëse pasqyrat financiare ne tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia, dhe dhenia e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguri e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një kontroll i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo pasaktësia dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rezikun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive, planifikojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit, që u pergjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për bazat e opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material, që vjen nga mashtrimi është më i lartë se ai që vjen nga gabimet, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, mospërfshirje të qëllimshme, keq paraqitje, apo tejkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit, që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njesisë ekonomike.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shënimeve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të parimit të vijmësisë në kontabilitet dhe, duke u bazuar në evidencën e marrë gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose rrethanat që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e njesisë ekonomike për të vazhduar në kushtet e vijmësisë së biznesit. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit për paraqitjen e këtij informacioni në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare ose, nëse keto shënime janë të papërshtatshme, për të modifikuar opinionin tonë.
- Në rastet e një misioni për auditimin e një grupi, marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënat financiare të njesive ekonomike ose aktiviteteve tregtare brenda grupit për të shprehur një opinion për pasqyrat financiare të grupit. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikqyrjen dhe cilësinë e auditimit të grupit. Ne jemi të vetmit përgjegjës për opinionin e auditimit.

Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana në të ardhmen mund të detyrojnë njesinë ekonomike të mos vazhdojë më në kushtet e vijmësisë së biznesit.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Midis çështjeve që ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë, nëse ka, ato çështje që kanë qënë më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht janë çështje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë keto çështje në raportin tonë të auditimit përveç rasteve kur ligjet apo rregulloret e ndalojnë paraqitjen publike të çështjes ose kur, në raste shumë të rralla, ne vendosim që një çështje nuk duhet komunikuar në raportin tonë të auditimit sepse ndikimi negativ që do kishte, do të tejkalonte mjaftueshëm përfitimet e interesit publik të këtij komunikimi.

Baker Tilly Albania shpk

Orjana Kalaja
Auditues Ligjor
Tiranë
27 mars 2018



GREEN COAST SHPK
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Periudha kontabel 01.01.2017 - 31.12.2017
(Vlerat ne Leke)

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016 (te paaudituar)
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	3	135.635.217	87.308.623
Te drejta te arketueshme	4	132.950	363.810
Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit	5	17.762.023	-
Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i ndertimit	6	1.882.154.325	763.909.192
Shpenzime te shtyra dhe te tjera te arketueshme	7	36.044.149	57.540
Totali i aktiveve afatshkurtra		2.071.728.664	851.639.165
Aktive afatgjate			
Aktive materiale	8	8.241.777	5.660.536
Aktive jomateriale	9	528.191	319.495
Totali i aktiveve afatgjata		8.769.968	5.980.031
TOTALI I AKTIVEVE		2.080.498.632	857.619.196
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Te paguëshme ndaj institucioneve financiare afatshkurtra	10	89.883.382	759.702
Te paguëshme per aktivitetin e shfrytezimit	11	78.474.679	25.094.452
Te paguëshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit afatshkurtra	12	82.924.738	33.236.661
Te paguëshme per detyrime tatimore	13	427.738	162.107
Te paguëshme te tjera	14	3.432.059	53.200
Totali i detyrimeve afatshkurtra		255.142.596	59.306.122
Detyrime afatgjata			
Te paguëshme ndaj institucioneve financiare afatgjate	10	1.511.487	2.358.127
Te paguëshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit afatgjata	12	114.661.842	49.649.278
Parapagime	15	907.293.977	342.311.237
Totali i detyrimeve afatgjata		1.023.467.306	394.318.642
Detyrime totale		1.278.609.902	453.624.764
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i nenshkruar	16	875.416.680	434.734.680
Humbja e mbartur		(30.740.248)	(9.386.304)
Fitimi i vitit		(42.787.702)	(21.353.944)
Totali i kapitalit		801.888.730	403.994.432
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2.080.498.632	857.619.196

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

GREEN COAST SHPK**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve dhe te ardhurave te tjera gjithepershires****Periudha kontabel 01.01.2017 - 31.12.2017***(Vlerat ne Leke)*

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016 (te paaudituar)
Te ardhura te tjera	17	2.282	-
Shpenzime per material dhe lende e pare	18	(16.790.915)	(3.943.372)
Shpenzime te personelit	19	(6.286.133)	(6.150.900)
Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi	8, 9	(1.623.327)	(387.403)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	20	(19.582.299)	(11.440.614)
Te ardhura financiare	21	1.715.174	632.052
Shpenzime financiare	22	(222.484)	(63.707)
Humbja para tatimit		(42.787.702)	(21.353.944)
Tatimi mbi fitimin	23	-	-
Humbja e vitit		(42.787.702)	(21.353.944)
Te ardhura te tjera gjithepershires per vitin			
Totali i humbjes gjithepershires per vitin		(42.787.702)	(21.353.944)

Pasqyra e te ardhurave gjithepershires duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur nga dhe miratuar ne 23 mars 2018 nga:

Englantina Perisnaka
 Pergatiti:
 Englantina Perisnaka
 Drejtore e finances

Evis Celiku
 Miratoi:
 Evis Celiku
 Administrator



GREEN COAST SHPK
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO
Periudha kontabel 01.01.2017 - 31.12.2017
(Vlerat ne Leke)

	Kapitali i nenshkruar	Humbja e mbartur	Totali i kapitalit
Pozicioni financiar ne 01 Janar 2016	70.045.680	(9.386.304)	60.659.376
Te ardhurat totale gjithëpërfshirë te vitit:			
Rritje kapitali	364.689.000	-	364.689.000
Humbja e vitit	-	(21.353.944)	(21.353.944)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirë per vitin	-	-	-
Transaksione me pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:	-	-	-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	-
Pozicioni financiar ne 31 Dhjetor 2016	434.734.680	(30.740.248)	403.994.432
Te ardhurat totale gjithëpërfshirë te vitit:			
Rritje kapitali	440.682.000	-	440.682.000
Humbja e vitit	-	(42.787.702)	(42.787.702)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirë per vitin	-	-	-
Transaksione me pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:	-	-	-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	-
Pozicioni financiar ne 31 Dhjetor 2017	875.416.680	(73.527.950)	801.888.730

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

GREEN COAST SHPK
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE
Periudha kontabel 01.01.2016 - 31.12.2016
(Vlerat ne Leke)

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016 (te paaudituar)
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Humbja e vitit	(42.787.702)	(21.353.944)
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>		
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jo-monetar		
Shpenzime amortizimi	1.623.327	387.403
Amortizimi i asetave te shitura	(79.266)	-
Shpenzime per interesa	222.484	63.707
<i>Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit</i>		
Renie/(rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	230.860	(226.530)
Rritje ne te drejtat e arketueshme me palet e lidhura	(17.762.023)	-
Rritje ne inventare	(1.154.231.742)	(503.919.999)
Rritje/(renie) ne detyrimet e pagueshme	736.708.099	248.535.245
Interes i paguar	(222.484)	(63.707)
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	(476.298.447)	(276.577.826)
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(4.777.624)	(6.367.434)
Shitje e asetave	443.625	-
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(4.333.999)	(6.367.434)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar	440.682.000	364.689.000
Arketime nga kredimarrja	89.076.500	2.358.127
Arketime nga qiraja financiare	47.180	759.702
Ri-pagesa per kredite e marra	(846.640)	-
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	528.959.040	367.806.829
Rritje/(Renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare	48.326.594	84.861.569
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fillim	87.308.623	2.447.054
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fund	135.635.217	87.308.623

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

1 Informacion i pergjithshem

Shoqeria Green Coast Sh.p.k ("Shoqeria") u themelua si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 29 Janar 2014 (data e themelimit) me aktivitet kryesor projektimi, ndertimi, venia ne shfrytezim, administrimi, mirembajtja, drejtimi dhe veprimtaria e resorteve turistike.

Zyra e regjistrimit te Shoqerise eshte Tirane, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati i IV.

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 Dhjetor 2017 ishte 19 punonjes (2016: 7 punonjes).

Pasqyrat financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 jane miratuar nga Administratori ne 23 mars 2018.

2 Baza e pergatitjes

a. Bazat e pregatitjes

Pasqyrat financiare individuale jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara, te aplikueshme per pasqyrat financiare qe mbulojne periudhat duke filluar nga 1 Janar 2016.

Drejtimi i Shoqerise vlereson se Shoqeria do te vijojte aktivitetin normal tregtar per 12 muajt qe pasojne muajin e mbylljes se ketyre pasqyrave financiare. Per rrjedhoje, sipas parashikimeve te Ligjit Nr. 9228, date 29 prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", pasqyrat financiare per vitin ushtrimor 2016 jane pergatitur ne baze te parimit te vijimesise.

Te dhenat aktuale jane te shprehura ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e shoqerise.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike

c. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit. si dhe koston e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes si ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorie

perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi tij. nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorieve.

Ne rastet kur pjese te nje aktiviteti afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme. Ato kontabilizohen si zera te ndryshme (komponentet me te medhenj) te aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur. dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii) Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeseve zevendesuese dhe kostoja e pjeseve mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

2. Bazat e pergatitjes (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden zbritese te amortizimit, mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktivitetit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi. Aktivitetet afatgjate jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe te perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme.

Me poshte jane normat e amortizimit te aplikuar:

• Ndertesa	5%
• Pajisje informatike	25%
• Pajisje zyre	20%
• Mjete transporti	20%

d. Llogarite e arketueshme dhe llogari te pagueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizionet per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshitesite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

e. Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat ne Lek dhe ne monedha te huaja. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne depozita pa afat ose me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

f. Transaksione ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diference qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet ne lidhje me AAM per t'u blere ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vleren e drejte rikembehin ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e zerave te bilancit ne monedhe te huaj ishin si me poshte (ne Lek):

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
1 EUR	132,95	135,23
1 USD	111,10	128,17

2. Bazat e pergatitjes (vazhdim)

GREEN COAST SHPK

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

Periudha kontabel 01.01.2017 - 31.12.2017

(Vlerat ne Leke)

g. Te ardhurat

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundshme qe perfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijne kompanise dhe keto perfitime mund te maten ne menyre te besueshme. Të ardhurat nga shitja njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqeria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë;
- Shoqeria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Eshtë e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga Shoqeria;
- Kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Te ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen ne pasqyrat financiare te periudhes te ciles i perkasin.

h. Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i ndertimit

Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i ndertimit perfaqesojne punimet ne proces per njohjen e se ciles eshte zbatuar parimi i metodes se perfundimit, ku faturimi kryhet duke u bazuar ne inspektimin e punes se kryer si edhe kostot e kryera deri ne daten e njohjes.

i. Parapagime

Parapagimet lidhen me pagesat pjesore ose te plote te palëve te treta, bazuar ne kontrata premtimi per shitjen e objekteve qe janë ne proces ndërtimi te Greencoast.

j. Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per tatimin mbi fitimin per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2017. Tatimi mbi fitimin perfshin teresisht tatimin mbi fitimin e llogaritur per periudhen kontabel. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit te tatueshem te percaktuar ne legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor ne Shqiperi per vitin 2017.

Tatimet e shtyra njihen duke perdorur metoden e bilancit duke marre parasysh diferencat e ne kohe midis tepricave te aktiveve dhe detyrimeve per raportimin ne pasqyrat financiare me vlerat e njohura per efekt tatimi fitimi. Tatimet e shtyra maten duke perdorur normen e tatim fitimit qe pritet te perdoret per diferencat ne kohe kur ato te rimerren bazuar ne ligjet qe jane miratuar ne daten e raportimit. Tatimet e shtyra aktive njihen deri ne masen e mundesise qe fitime te ardhshme tatimore do te jene te disponueshme qe diferencat ne kohe te perdoren. Tatimet e shtyra jane rregjistruar si korrigjim i detyrimit/(rimbursimit) per tatim fitimi.

k. Krahasueshmeria

Informacioni krahasues paraqitet ne menyre te vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabel te Shoqerise dhe duke u bazuar ne modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabel Shqiptar.

l. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

GREEN COAST SHPK
Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
Periudha kontabel 01.01.2017 - 31.12.2017
(Vlerat ne Leke)

3 Mjete monetare

Mjete monetare dhe ekuivalente me to perbehet si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Vlera ne arke	335.029	977.179
Vlera në lekë në arkë	117.523	977.179
Vlera në euro në arkë	217.506	-
Vlera ne banka	135.300.188	86.331.444
Vlera në lekë në bankë	741.076	1.675.724
Vlera në euro në bankë	134.559.112	84.655.720
Totali	135.635.217	87.308.623

4 Te drejta te arketueshme

Te drejta te arketueshme perbehet te drejta te arketueshme per sherbimet e kryera klienteve si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kerkesa per arketim	132.950	363.810
Totali	132.950	363.810

5 Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te arketueshme Mane TCI	37.971	-
Te arketueshme Green Coast 2	17.395.382	-
Te arketueshme Agrocon shpk	328.670	-
Totali	17.762.023	-

6 Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i ndertimit

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Ndertime ne process	1.840.725.727	740.706.639
Parapagime	41.428.598	23.202.553
Totali	1.882.154.325	763.909.192

Ndertime ne proces lidhen me parapagimet e kryera ndaj palëve te treta, per ndërtimin e Objektivit GreenCoast.

7 Shpenzime te shtyra

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shteti TVSH e zbritshme	15.150.615	-
Te tjera tatime per tu paguar dhe per tu kthyer/dogana	12.250.956	-
Shpenzime te periudhave te ardhshme	3.238.978	57.540
Kosto financiare te llogaritura per tu shperndare	5.403.600	-
Totali	36.044.149	57.540

GREEN COAST SHPK
Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
Periudha kontabel 01.01.2017 - 31.12.2017
(Vlerat ne Leke)

8 Aktive materiale

	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Paisje kompjuterike	Paisje zyre	Totali
Kosto					
Me 01 Janar 2016	-	-	-	-	-
Shtesa	4.081	4.296.281	1.231.166	454.060	5.985.588
Me 31 Dhjetor 2016	4.081	4.296.281	1.231.166	454.060	5.985.588
Shtesa	-	-	2.345.749	2.122.685	4.468.435
Shitje	-	-	(352.905)	(90.720)	(443.625)
Me 31 Dhjetor 2017	4.081	4.296.281	3.224.010	2.486.025	10.010.397
Amortizimi i akumuluar					
Me 01 Janar 2016	-	-	-	-	-
Amortizimi per vitin	98	187.748	107.059	30.147	325.052
Me 31 Dhjetor 2016	98	187.748	107.059	30.147	325.052
Amortizimi per vitin	797	821.707	451.030	249.300	1.522.834
Rimarrje amortizimi	-	-	(72.932)	(6.334)	(79.266)
Me 31 Dhjetor 2017	895	1.009.455	485.157	273.113	1.768.620
Vlera kontabel neto:					
Me 01 Janar 2016	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2016	3.983	4.108.533	1.124.107	423.913	5.660.536
Me 31 Dhjetor 2017	3.186	3.286.826	2.738.853	2.212.912	8.241.777

9 Aktive jo materiale

	Software	Totali
Kosto		
Me 01 Janar 2016	-	-
Shtesa	381.846	381.846
Me 31 Dhjetor 2016	381.846	381.846
Shtesa	309.189	309.189
Me 31 Dhjetor 2017	691.035	691.035
Amortizimi i akumuluar		
Me 01 Janar 2016	-	-
Amortizimi per vitin	62.351	62.351
Me 31 Dhjetor 2016	62.351	62.351
Amortizimi per vitin	100.493	100.493
Me 31 Dhjetor 2017	162.844	162.844
Vlera kontabel neto:		
Me 01 Janar 2016	-	-
Me 31 Dhjetor 2016	319.495	319.495
Me 31 Dhjetor 2017	528.191	528.191

GREEN COAST SHPK
Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
Periudha kontabel 01.01.2017 - 31.12.2017
(Vlerat ne Leke)

10 Te pagueshme ndaj institucioneve financiare

Te pagueshme ndaj institucioneve financiare konsiston huamarrje ndaj bankave te nivelit te dyte, dhe te qirase financiare te pagueshme brenda vitit pasardhes.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Detyrimi i mbetur per qirane financiare	806.882	759.702
Huamarrje nga bankat e nivelit te dyte (afatshkurter)	89.076.500	-
<i>Totali i detyrimeve afatshkurtra ndaj institucioneve financiare</i>	89.883.382	759.702
Huamarrje nga bankat e nivelit te dyte (afatgjate)	1.511.487	2.358.127
Totali	91.394.869	3.117.829

11 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit perfshin detyrimet nga furnitoreve vendas dhe te huaj per sherbimet e marra gjate vitit.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Furnitore per mallra	78.256.679	24.672.479
Furnitore per fatura te pamberritura	218.000	421.973
Totali	78.474.679	25.094.452

12 Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit

Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit perfshin detyrimet si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<i>Detyrime ndaj pjesetareve te tjere te grupit (pjesa afatshkurter)</i>		
